

**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare**  
**“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN**  
**E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”**  
**24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri**

**FONDET E INVESTIMIT NË SHQIPËRI. KRAHASIM ME FONDET E INVESTIMIT**  
**NË BOTË**

**Dr. Jonada Mamo<sup>1</sup>**  
**Julja Basha<sup>2</sup>**

*Abstrakt*

Tregu i Fondeve të Investimit ka njohur një rritje të shpejtë që nga krijimi i tij e deri në ditët e sotme. Ky punim ka në fokus analizën dhe studimin e fondeve të investimit, të cilat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në grumbullimin e aseteve financiare që menaxhohen nga një shoqëri e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Objektivi parësor është investimi i këtyre parave në mënyrë që të prodhojnë fitim për investitorët. Ecuria e fondeve ka qenë pozitive gjatë gjithë ekzistencës së tyre dhe objektivi është arritur duke prodhuar një kthim vjetor më të lartë se depozitat. Analizimi i elementeve të secilit prej fondeve fokusohet në studimin e të dhënave primare dhe sekondare të grumbulluara duke shpjeguar më së miri ecurinë dhe krahasimin në vite. Fondi do të synojë që të jetë në përputhje me tregun në kushte të qëndrueshme të tregut dhe të normave të interesit duke marrë në konsideratë përbërjen e portofolit, nivelin e rrezikut dhe maturitetin mesatar të tij.

Në konkluzion, përveç avantazheve që këto fonde mbartin për kthimin e lartë dhe kontroll online në llogari, analizohen edhe faktorë të tjerë që i rrezikojnë këto fonde si dhe një krahasim i mirëfilltë me fondet e investimit nëpër botë.

***Fjalët kyçe:** Fondet e Investimit, Investime të lejuara, institucion financiar, AMF.*

---

<sup>1</sup> Lecturer “Aleksandër Moisiu” University, Faculty of Business, Durrës, Albania e-mail: [jonada.mamo@yahoo.com](mailto:jonada.mamo@yahoo.com)

<sup>2</sup> Student in Master of Science, “Aleksandër Moisiu” University, Faculty of Business e-mail: [juljabasha@outlook.com](mailto:juljabasha@outlook.com)